

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**PSH.nr 231/21**

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej znj. Nita Bejta- Kryetare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “CV SHPK” - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Vlerësimi i Pronave dhe Qirave të Ndërmarrjes Publike Banesore”, me nr. të prokurimit: 1909466981031194-22-2679-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Ndërmarrja Publike Banesore, më datën: 17.08.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “CV SHPK” - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Vlerësimi i Pronave dhe Qirave të Ndërmarrjes Publike Banesore”, me nr. të prokurimit: 1909466981031194-22-2679-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Ndërmarrja Publike Banesore.

II. ANULOHET, vendimi i AK- Ndërmarrja Publike Banesore për njoftim për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit “Vlerësimi i Pronave dhe Qirave të Ndërmarrjes Publike Banesore”, me nr. të prokurimit: 1909466981031194-22-2679-2-2-1 dhe lënda kthehet në Ri-vlerësim.

III. OBLIGOHET, Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarrja lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik “CV SHPK” - Prishtinë, aprovet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. OBLIGOHET operatori ekonomik CV SHPK – Prishtinë që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues : “CV SHPK” - Prishtinë, ka parashtuar ankesë me nr: 231/22, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Vlerësimi i Pronave dhe Qirave të Ndërmarrjes Publike Banesore”, me nr. të prokurimit: 1909466981031194-22-2679-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Ndërmarrja Publike Banesore.

Operatori ekonomik ankesën e ka ndare në dy pjesë, me pretendimet e pjesës së parë kundërshton eliminimin si veprim në kundërshtim me dispozitat e LPP-se dhe RrUOPP-se, si dhe në pjesën e dytë kundërshton njoftimin për OE të rekomanduar si të papërgjegjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-se dhe RrUOPP-se.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 28. 06. 2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 29. 06. 2022, në raportin e ekspertizës ka sqaruar se:

### Sqarimi nr.1

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues se AK e ka eliminuar jashtëligjshëm, pasi që ka dorëzuar listën e kontratave, por AK e ka eliminuar.

Në kriterin e FDT-se dhe Njoftimit për kontratë lidhur me këtë pretendim të OE ankues është kërkuar kriteri:

*Kërkesa 2 Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratë të natyrës së ngjashme siç janë, (vlerësimi i pasurisë, objekteve dhe qirave), në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 30,000.00 €. Kurse dëshmia lidhur me këtë kërkesë të FDT-se është se: Dëshmia për kërkesën 2. Një listë të shërbimeve të realizuara në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, duke saktësuar shërbimet e kryera, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur shërbimet janë kryer për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi shërbej në (reference pozitive ose raporti i pranimi të shërbimit) të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë (ii) kur shërbimet janë kryer për një person kompani private, për dëshmi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi siç janë: (reference pozitive, raportet e pranimi apo kontrata), por që këto dokumente të jenë të pranueshme duhet të dëshmohen me (transaksion bankar).*

Lidhur me këtë pretendim ankimor të OE ankues, sqarojmë se lista e bashkangjitur e projekteve nuk është siç është kërkuar në kriterin e FDT-s: Një listë të shërbimeve të realizuara në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, duke saktësuar shërbimet e kryera, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit.

Lista e bashkangjitur e OE ankues, nuk ka vlere por vetëm përshkrimin, të bashkangjitur gjeni listën e OE ankues.

Client	Contact address	Contact Number
Pro Credit Bank	Njësia e Prokurimit dhe Kontrollit Financiar ProCredit Bank, Kosovë Bulevardi "Nëna Terezë", Nr.16 Prishtinë, Kosovë	Tel: + 383 (38) 555 777 Fax:+ 383 (38) 248 777 procurement@procreditbank-kos.com http://www.procreditbank-kos.com
Raiffesien Bank Kosovo	Risk Department Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C HQ in Prishtina, UCK Street, No. 51,	Risk Department Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C E-mail: rbko.collateral@raiffeisen-kosovo.com
TEB Sha	Procurement Office Facility and Procurement Department Head Office Rr. Agim Ramadani, No. 15, 10000 Prishtina	Djemal Edip T: 038 230 123 M:+383 (49) 789 008 djemal.edip@teb-kos.com or Vjosa Cena, procurement.vjosa.cena@teb-kos.com teb-kos.com
Is Bank	Branch Manager Turkiye İş Banksı A.S. Kosovo Branch Ukshin Hoti, Nr. 100, Prishtinë, 10000	<b>VALON SHEHU</b> Branch Manager Prishtine Branch/Kosovo Tel +38338245245-1008 Mob +383 49 904 544
Ndërmarrja publike banesore	Ndërmarrja Publike Banesore SHA a:Bill Clinton Str 34, 10000 Prishtinë	Nexhat Kryeziu Kryeshef Ekzekutiv m:+381 (0) 38 523 001 w:www.npbanesore.com e:nexhat.kryeziu@npban
MeridianExpress LLC	AGON GASHI   CEO   Bulevardi Bill Clinton, Zona Industriale pn.	t: +381 38 40-20-40 ext 5000   f: +381 38 60-63-60   m: +386 49 248

Pra, lista e bashkangjitur e OE ankues, nuk është konform kërkesës së FDT-se, pasi që nuk përmban shumën e kontratës, datën e pranuesit të shërbimit, por përmban Emrin e kompanisë, Përfaqësuesi dhe adresa e kompanisë dhe nuk e përmban Shërbimet e kryera, shumën e projektit, datën e pranimi

Pra, lista e OE ankues (CV SHPK) nuk është konform kërkesës së AK-se.

Po ashtu, OE ankues (CV SHPK) ka bashkangjitur kontratat e të cilat janë pa vlerë, e që i njëjti i ka bashkangjitur edhe transaksionet bankare gjë e dëshmon qarkullimin, por Lista e kontratave, nuk

është konform kërkesave të FDT-se dhe Njoftimit për kontratë. Pra, lista e prezantuar nga OE ankues nuk e përmbush kriterin e kërkuar të dosjes dhe njoftimit për kontratë.

#### Sqarimi nr.2

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankuese lidhur me listën e stafit

Pika 1 – paragrafi 2 – “Sa i përket pikës së dytë se kinse kam ofruar vetëm 3 vlerësues kjo nuk qëndron për faktin se ne kemi dorëzuar dokumentacionin që faktori se z. Bujar Prestreshi do të jete i angazhuar në këtë projekt dhe është dorëzuar së bashku me dëshmitë”

Kërkesa sipas dosjes së tenderit është kërkuar: që OE duhet të prezantojë stafin nevojshëm min 08 punëtor që do të angazhohen në këtë projekt, i gjithë stafi duhet të jete i diplomuar ose certifikuar licencuar. Profilet e punëtorëve që kërkohen janë si në vijim: Kërkesa c) Min katër (4) punëtor të certifikuar – licencuar si vlerësues të shkallës së parë, me së paku 3 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit certifikimit licencimit)

Dëshmia e kërkuar dokumentare: a) Një Listë me numrin e punëtorëve që angazhohen për kryerjen e shërbimeve, minimum. 08 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vërtetuar nga Operatori Ekonomik.

c) Dëshmia për vlerësues, CV-ja kopje e nënshkruar nga Vlerësuesi, diploma ose certifikata ose licenca kopje, kontrata valide e punës me punëdhënësin ose para kontratës, kopje. Si dhe letër Reference ku dëshmohet përvoja e punës prej tri viteve të lëshuar nga punëdhënësi .

“Ne kemi ofruar referencat si ku dëshmohet përvoja e punës prej tri viteve të lëshuar nga punëdhënësi dhe referencën nga firma CV shpk ku dëshmon se është i angazhuar si vlerësues, si dhe është paraqitur në listën e stafit të nënshkruar në origjinal nga ne, CV e nënshkruar nga vet Bujar Prestreshi së bashku me licencën dhe referencat tjera, si dhe paraqesim për kontratën dokumente këto lehtë të verifikohen që vërtetojnë se z. Bujar Prestreshi që përpos që punon në firmën e vet është i angazhuar nga CV shpk ku AK nëse ka pasë të pakjart ka mundur të kërkojë sqarime shtesë. Ne nuk mashtrojmë por e deklarojmë të vërtetën. AK gjatë vlerësimit nuk i ka marrë parasysh fare CV e nënshkruar nga vet Bujar Prestreshi, nuk e ka marrë parasysh as licencën, nuk e ka marrë parasysh as listën e punëtorëve të propozuar dhe nënshkruar nga ne në origjinal, nuk e ka marrë parasysh e as dhe letër-konfirmimin ku vërtetohet se z. Prestreshi është i angazhuar nga ne si dhe as nuk e ka përdorë obligimin ligjor të kërkojë sqarime shtesë për të konfirmuar.”

Lidhur me pretendimin e OE ankues, lista e bashkangjitur nga OE ankues, e plotëson kërkesën e kërkuar në Kriterin e kërkuar në NJOFTIM PER INFORMATA SHITESË ose PERMIRESIM GABIMI, që thotë si : Kërkesa 1 a) OE duhet të prezantojë stafin e nevojshëm min 08 punëtor që do të angazhohen në këtë projekt, i gjithë stafi duhet të jete i diplomuar ose certifikuar licencuar. Profilet e punëtorëve që kërkohen janë si në vijim; b) Min tre (3) Kontabilist të certifikuar- me së paku 3 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit). c) Min katër (4) punëtor të certifikuar licencuar si vlerësues të shkallës së parë, me së paku 3 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit certifikimit licencimit). d) Min një (1) Gjeodet të diplomuar min niveli Bachelor, me së paku 3 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit).

OE e ka bashkangjitur listën e punëtorëve me 08 punëtor që i ka të 4 vlerësues të pronave, 3 kontabilist të certifikuar dhe 1 gjeodet.

Lidhur me vlerësuesin Bujar Prestreshi, nuk qëndron arsyetimi i AK-se, se ky OE është i punësuar në një kompani tjetër, sepse në kriterin e kërkuar nga vet AK, është cekur “do të angazhohen”, e nuk ceket që kompania të ketë punëtorët e rregulltë.

Pra, pretendimi i OE ankues në këtë pikë qëndron, sepse CV shpk e ka angazhuar si staf për

projektin ne fjale.

### Sqarimi nr.3

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, se ky OE e ka listën e stafit si te dyshimte, dhe pretendon se ka mashtruar AK-se, duke e shkelur deklaratën nen betim, ju sqarojmë se OE i rekomanduar ka te bashkangjitur listën e stafit siç është kërkuar ne kriteret e AK-se.

Ku sipas kësaj liste janë te paraqitur 4 vlerësues, 3 kontabilist dhe 1 gjeodet.

Mendoj se lista e përmbush kriterin e kërkuar, por siç pretendon OE ankues, se ka bere mashtrime, këtë përgjegjësi e ka AK për verifikimin e listës apo ne rast te mashtrimit qe mund te ketë janë organet kompetente qe merren me vërtetësinë.

Por, siç pretendon OE ankues, se OE i rekomanduar Listën e ka bashkangjitur ne kopje e jo ne origjinal siç është kërkuar, pasi qe kriteri i dosjes ka qene (citim): a) OE duhet të prezantojë stafin e nevojshëm min 08 punëtor që do të angazhohen në këtë projekt, i gjithë stafi duhet të jete i diplomuar ose certifikuar licencuar. Profilet e punëtorëve që kërkohen janë si në vijim:

Min tre (3) Kontabilist të certifikuar- me së paku 3 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit).

Min katër (4) punëtor të certifikuar licencuar si vlerësues të shkallës së parë, me së paku 3 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit certifikimit licencimit).

Min një (1) Gjeodet të diplomuar min niveli Bachelor, më së paku 3 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit).

Dëshmia - Lista e numrit të punëtorëve që angazhohen për kryerjen e shërbimeve, minimum. 08 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, moshë e punëtorit, profesioni, eksperiencën (vite) dhe pozicioni në kompani — duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik. b) Dëshmia për Kontabilist, CV-ja kopje e nënshkruar nga Kontabilisti, diplotna ose certifikata kopje, kontrata valide e punës me punëdhënësin ose para kontratë, kopje. Si dhe letër Reference ku dëshmohet përvoja e punës prej tri viteve e lëshuar nga punëdhënësi. c) Dëshmia për vlerësues, CV-ja kopje e nënshkruar nga Vlerësuesi, diploma ose certifikata ose licenca kopje, kontrata valide e punës me punëdhënësin ose para kontrata, kopje. Si dhe letër Reference ku dëshmohet përvoja e punës prej tri viteve e lëshuar nga punëdhënësi . d) Dëshmia për Gjeodet, CV-ja kopje e nënshkruar nga Gjeodeti, diploma kopje, kontrata valide e punës me punëdhënësin ose parakontrata, kopje. Si dhe letër Reference ku dëshmohet përvoja e punës prej tri viteve e lëshuar nga punëdhënësi .

Lidhur me këtë pretendim qëndron pretendimi i OE ankues, se ne kriter ka qene qe duhet te dorëzohen, pasi qe ne sistemin elektronik “ngarkohet dosja ne origjinal”, dhe “nuk dorëzohen fizikisht”, por si do qe te jete ka qene kërkesë e dosjes, dhe AK nuk e ka respektuar këtë pike si te ka kërkuar ne kërkesën e tij. Pra, AK mund te kërkoj sqarime shtese lidhur me listën edhe pse është kërkuar origjinal dhe është ngarkuar nga OE i rekomanduar ne kopje, me këtë AK mund te kerkoj sqarime sipas nenit 72 te LPP-se dhe te vërtetoj.

Po ashtu OE ankues pretendon se referencat e te punësuarave janë te dyshimta. Ne dosjen e OE se rekomanduar shihet se Referencat e bashkangjitura te stafit janë kryesisht nga kompania e rekomanduar për kontrate Pro Acc Group SHPK, me këtë AK mund te kërkoje sqarime dhe dëshmi sipas nenit 72 te LPP-se qe te vërtetohen se a kanë qene apo jo punëtorë te kompanisë 3 vitet e fundit siç janë kërkuar ne kriteret e FDT-se?

Po ashtu qëndron pretendimi i OE ankues se Hysen Ramabaja dhe Lulzim Krasniqi nuk kane te bashkangjitur Licencat siç janë kërkuar, por njeri ka te bashkangjitur Certifikatën e anëtarësisë dhe tjetri ka te bashkangjitur vërtetimin për fitimin e thirrjes Auditor i Certifikuar.

Për këtë pretendim AK mendoj te kërkoj sqarime shtese lidhur me emrat e lartshënuar dhe te sqarohet sipas nenit 72 te LPP-se sipas kriterit te kërkuar... kopje e nënshkruar nga Kontabilisti,



diploma ose certifikata kopje.

Lidhur me pretendimin për referencën e Lulzim Krasniqit, e cila është lëshuar me dt.20.04.2022 nga kompania ADVANCED BUSINESS CONSULTING SHPK (me nr.biznesi 810847220), kjo kompani është aktive e jo siç pretendon OE ankues në një kompani me nr.biznesi 810f04640 cila është pasive që nga viti 2019.

Po ashtu lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues, se Hysen Ramabaja, ka një reference të dt.02.04.2021 të lëshuar nga H&N AUDIT SHPK, Referenca ka përmbajtjen se personi në fjalë ka kryer auditimin e pasqyrave financiare nga viti 2012 për auditim e jo për kontabilist, mendoj se ky pretendim është i paqëndrueshëm për shkak se auditori është një shkallë më e lartë se kontabilisti. Pra, nuk mundet me qene auditor pa qene kontabilist i certifikuar.

Mendoj se nuk qëndron pretendimi i OE ankues në këtë pikë..

Lidhur me kontabilistin e certifikuar Burim Selmani, pretendon OE ankues, se ka referencën e lëshuar nga Pro Acc Group dhe se pretendon se i njëjti është pronar i kompanisë BORA SHPK, dhe se referenca është lëshuar nga OE i rekomanduar.

Lidhur me këtë pretendim mendoj se këtë mund ta qartëson AK sipas nenit 72 të LPP-se, pasi që OE i rekomanduar i ka lëshuar reference dhe se ka pretendim se nuk është e vërtetë deri sa në sistemin figuron se Burim Selmani ka një biznes me emër BORA SHPK. Kjo është e lehtë të verifikohet, por edhe pse ligji e lejon që çdo person mund të ketë punë dytësore, por se a ka punuar apo jo në kompaninë Pro Acc Group, kjo mund të vërtetohet nga AK përmes listës së punëtorëve të kompanisë nga ATK-ja se a ka qene i punësuar i kësaj kompanie nga viti 2018. Pra, kjo mund të sqarohet sipas kriterit të kërkuar b) Dëshmia për Kontabiliste, CV-ja Kopje e nënshkruar nga Kontabilisti, diploma ose certifikata kopje, kontrata valide e punës me punëdhënësin ose para kontratës, kopje. Si dhe letër Reference ku dëshmohet përvoja e punës prej tri viteve të lëshuar nga punëdhënësi .

Pra, AK mund ta sqaron sipas nenit 72 të LPP-se.

#### Sqarimi nr.4

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues, për kriterin që është kërkuar :

OE të ofroj minimum 4 punëtor të certifikuar të licencuar si vlerësues të shkallës së parë, me së paku 3 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit, licencimit, certifikimit)

Dëshmia e kërkuar dokumentare: c) Dëshmia për vlerësues, CV-je kopje e nënshkruar nga Vlerësuesi, diploma ose certifikata ose licenca kopje, kontrata valide e punës me punëdhënësin ose para kontratës, kopje. Si dhe letër Reference ku dëshmohet përvoja e punës prej tri viteve të lëshuar nga punëdhënësi. OE pretendon se vlerësuesit e paraqitur të OE të rekomanduar Arian Shala, Arben Bajramaj, Behar Jonuzi dhe Lorida Sylejmani nuk kanë dorëzuar letër reference ku për disa nuk dëshmohet përvoja e punës prej tri(3) viteve të lëshuar nga punëdhënësi i vërtetë e që vërtetojnë përvojën e punës.

Lidhur me dosjen për Arian Shala në dosjen e OE të rekomanduar janë të bashkangjitura Licence, Kontrata e punës, CV dhe Referenca

Sipas kriterin është kërkuar që këto dëshmi të ketë vlerësuesi dhe se a është e vërtetë apo jo që punon edhe në bankë edhe në Kompaninë Pro Acc Group, në CV-në e të punësuarit thotë se punon në këtë kompani nga viti 2017 Part Time, prove CV-në e Arian Shales.

Në CV e tij thotë se pozita e tij është Specialist i Vlerësimeve.

Po ashtu lidhur me pretendimin se Arben Bajramaj se në CV e tij shkruan se është i punësuar në Bankën ekonomike (BEK), dhe ka Kontratë punës me orar të shkurtuar me kompaninë Pro Acc

Group.

Po ashtu ceket se ka punuar ne Ndërmarrjen Publike Banesore si menaxher i financave nga Marsi 2009 deri ne mars 2011, dhe mendoj se kjo nuk paraqet ndonjë konflikt interesi pasi qe tani me jemi ne vitin 2022 dhe ka me shumë se 11 vite nga momenti qe ka ndërprere marrëdhënien e punës.

Pra, nuk mendoj se mund te paraqet ndonjë konflikt interesi dhe ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin Lorida Sylejmani, e cila eshte vlerësuese e pronave dhe se referencen e ka te leshuar nga vet OE i rekomanduar Pro Acc Group, e njëjta ne dosje ka te bashkangjitur Licencen per Vleresues te Pronave te Paluajtshme me nr. te licencës 281 nga data 13.09.2021 deri 12.09.2022 Pra, ne dosjen e saj gjinden tri (3) licenca: a) 17.11.2017 — 17.11.2019; b) 07.11.2019 — 07.11.2021 dhe c) 13.09.2021 — 12.09.2022.

Lorida Sylejmani sipas linkut qe keni bashkangjitur te vitit 2021 e vërtete qe licencën e ka pasur pasive, por ne listën e vitit 2022 e cila gjendet ne web faqen e Këshillit Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësueseve [https://mf.rks-gov.net/pace.aspx?id=1, 183](https://mf.rks-gov.net/pace.aspx?id=1,183) dëshmohet se Lorida Sylejmani ka licencë valide prej dates 13.09.2021 deri 12.09.2022

Pra, sipas licencave qe i ka te bashkangjitura dëshmohet se ka me shume se 4 vite përvojë pune, por për çdo paqartësi kjo mund ta vërteton sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se edhe pse kërkesa e AK-se, sipas këtyre licencave qe i ka bashkangjitur ne dosjes plotësohet

Siç pretendon OE ankues se janë kontratat e kundërligjshme sipas Ligjit te Punës, kjo bie mbi përgjegjësinë e Kompanisë Acc Pro Groups por edhe ne kriteret e dosjes se tenderit nuk janë kërkuar të jenë kontratat siç pretendon OE ankues, por thuhet kontrate ose para kontrate.

Lidhur me deklaratën se a janë te rreme apo te vërteta, për çdo dyshim qe mund te ketë për mashtrim, mund ti drejtohet organeve kompetente ne rast se dyshon ne mashtrime, por bazuar ne provat qe janë te bashkangjitura ne dosje gjinden dokumentet e kërkuara, kurse ne nuk kemi qasje ne data bazën e kompanive qe te verifikojmë dyshimet e tilla sic pretendon OE ankues.

#### Sqarimi nr.5

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues se Gjeodeti nuk e plotëson kriterin se nuk ka licence valide dhe nuk përmbush kriterin e përvojës profesionale pas diplomimit sepse nuk ka pune profesionale ngase nuk ka licence.

CV e dorëzuar nuk dëshmon se ka qene i licencuar dhe as qe ka përvojë profesionale tre vjeçare pasi qe për përvoje profesionale duhet licence. Njëra reference ka përmbajtje te rreme pasi qe i referohet si inxhinier i gjeodezie e qe nuk eshet sipas kërkesës se FDT-se, sqarojmë se kriteri i kërkuar ka qene:

d) Min nje (1) Gjeodet te diplomuar min niveli Bachelor, me se paku 3 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit).

d) Dëshmia për Gjeodet, CV-ja kopje e nënshkruar nga Gjeodeti, diploma Kopje, kontrata valide e punës me punëdhënësin ose para kontrata, kopje. Si dhe letër Reference ku dëshmohet përvoja e punës prej tri viteve e lëshuar nga punëdhënësi.

Me këtë sqarojmë se AK ka kërkuar 1 gjeodet te diplomuar minimiim niveli bachelor, e qe OE i rekomanduar e ka bashkangjitur Agron Shabani, ku e ka te bashkangjitur Diplomen e fakultetit (bachelor i gjeodezise), CV-ne, kontratën e punës dhe referencat.

Ne CV e bashkangjitur te pozicioni eksperiencia e punës, shkruan se 2 vite ka punuar te NTP "LORI", kurse nga viti 2013 është i angazhuar ne NTP Geo-Map, gje qe i dëshmon me referenca te punës.

Kurse sa i përket pretendimin ankimor se Gjeodeti nuk e ka Licencën, ju sqarojmë se bazuar ne kriteret e kërkuam te FDT-se kërkohet: Dëshmi për Gjeodet, CV-ja kopje e nënshkruar nga Gjeodeti, diploma kopje, kontrata valide me punëdhënësin ose para kontrata, kopje. Si dhe leter Reference ku dëshmohet përvoja e punës prej tri viteve e lëshuar nga punëdhënësi. Pra, AK nuk e ka kërkuar licencën për gjeodetin, por nëse sipas ligjit mbi kadastrën kërkohet që gjeodeti të ketë licence, kjo bie mbi përgjegjësinë e AK-se, që nuk e ka kërkuar Licencën ne kriteret e dosjes së tenderit.

-Përgjegjësia e AK-se gjatë rivlerësimit të kërkoj sqarime shtese sipas sqarimeve të dhëna si me larte, lidhur me dokumentet e kërkuara si ne kriteret o dosjes dhe njoftimit po ashtu bie mbi përgjegjësi të AK-se respektimi i dispozitave ligjore bazuar ne nenin 1 dhe 6 te LPP-se, dhe bazuar ne kriteret e kërkuara dhe të respektoj nenin 59 të LPP-se, konkretisht 59.4 të këtij neni.

### **MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES**

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna me larte), eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE-se ankues të aprovohet pjesërisht të bazuar dhe lënda të kthehet ne rivlerësim dhe gjatë rivlerësimit të vlerësohen ofertat sipas kriterëve të FDT-se dhe Njoftimit për kontratë konform nenit 59 të LPP-se, dhe për çdo paqartësi që ka AK të respektohen dispozitat ligjore të LPP-se, për sqarime shtesë sipas nenit 59.2, neni 72 të LPP-se dhe neni 39.8 i RuUOPP-së, duke marr parasysh kursimin e buxhetit sipas nenit 1 dhe 6 të LPP-se.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 12 Korrik 2022 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë 12 korrik 2022, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues me datën 13 korrik 2022 me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pjesërisht nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca e shqyrtimit kryesor është mbajtur me datën: 15 Gusht 2022, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, deklaratave të palëve ne procedure, njoftimi për anulim, kërkesa për rishqyrtim, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Ne baze të autorizimit, operatorin ekonomik e ka përfaqësuar avokat zt.Osmani i cili deklaroj: ne ekspertizën e ekspertit nuk e ka cek që gjeodeti duhet të jetë i licencuar pasi që OE i propozuar në tabelën e vet e ka cekur që është i licencuar mirëpo nuk ka ofruar asnjë dëshmi për licencë nuk ekziston ne regjistrin e gjeodeteve, sepse sipas ligjit 04L013 PER kadastrë gjeodeti duhet të jetë i licencuar për më krye punët gjeodezike.

Gjithashtu eksperti sipas rregullores së OSHP ka obligim që të bëjë edhe disa hulumtime shtesë ku e ka sipas nenit 19 paragrafi 2 dhe të mbledhë dëshmi si dhe 19.1 i ka obligim të gjitha pretendimet e përfshira si dhe pretendimet që nuk janë parashtrua,

Eksperti është dashtë me cek se edhe herën e parë e ka shpall fitues kundërligjshëm Baker Tilly me të cilën jam ankuar ne si OE ankuese.

Çuditërisht kam marr qasje në dosje të fituesit të parë dhe dosjen time por nuk ka përshtur ankesë pra që do të thotë lind dyshimi se ka qenë diçka e aranzhuar sepse unë kur e kam parë që nuk i plotëson



kriteret un jam ankuar. Ne kemi te bëjmë me një OE qe është shpall fitues dhe ka qasje ne dosje ndërsa nuk ka ankesë.

Për pjesën tjetër te lista e kontratave unë habitem psh eksperti është dashtë te cek mirë se këta nuk kanë kërkuar listë te kontratave por listë te shërbimeve pra me rregullore qe e kom ofruar se unë nuk kom than listë te kontratave por listë te referencave janë kua janë data qe është bere pagës me dëshmi kemi me çmime njësi qe ne asnjë referencë nuk është bere shuma totale por i kemi me çmime ne njësi unë nuk kom ofruar listë te kontratave.

Kërkesa nr 2: OE duhet te ofroj dëshmi por ndonjë listë te realizuar ne tre vitet e fundit duke saktësuar. Pra këtu ka te gjitha elementet qe unë i kom bere te gjitha dëshmitë unë i kom ofruar kontratat këto dokumente te janë te pranueshme duhet te dëshmohej me transaksion bankar ku unë i kom paraqit. Ndërsa ne rregulloren e prokurimit lista kontratave te realizuar nuk përmbush kërkesat minimale. Unë kom paraqit referencë.

Kemi dy CV te dy personave janë publike nuk cekëte askund ku punon Arben Bajramaj, punon ne bankën e ekonomike punëtori i vet ja mbikëqyr punën.

Tjetra është se nuk e ka cek se mu nuk me është lejuar qasje për me pa mundësuar ankesë te drejt edhe Lulëzimi edhe aj nuk i e kanë cek qe punojnë për ACC tash kemi gjet se nuk ka punuar te firma e vllahut te tina nuk dëshmojnë se kanë punuar si kontabiliste si te certifikuar.

Unë i kom pa vetëm dy licenca qe mbulojnë vetëm dy vjet e gjysme përvojë pune (Lorida Sylejmani)

Ne vazhdim fjalën e mori përfaqësuesi sipas autorizimit i Autoritetit Kontraktues zt. Fatmir Krasniqi i cili deklaroj: Sa i përket pretendimeve te OE, sa i perfekt kriterit te dytë është e qarte kontrata është shërbime sipas ligjit ka me kry shërbim ka me vlerësim te pasurive, me eksperti është hera e par qe ne nuk pajtohem edhe AK nuk pajtohem se pse me kthye ne rivlerësim. Unë kur i kom kërkuar dokumente e përshtatshmërisë te gjitha listat origjinale qe janë kërkuar janë te dorëzuar nga OE edhe aj ma herët edhe ky fitues. Un sipas nenit 72 te LPP nuk mund te kërkoj dokumente shtesë Listën e stafit e ka ne rregull por kur e largon nga lista Bujar Prestreshin mbesin 7. Nëse kthehet ne rivlerësim kemi te njëjtën situatë prapë.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Bushi i cili deklaroj: un si eksperti i kam shqyrtua pretendimet ankimore sipas pretendimeve ankimore te paraqitura ne ankesë dhen nuk kam kompetencë te shqyrtoj pretendime qe nuk janë ne ankesë sepse nuk është kompetencë e imja ligjore.

Lidhur me pretendimin e parë ankimor kërkesa e FDTe njoftimit për kontratë ka qen OE duhet te ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te natyrës se ngjashme ( vlerësimi i pasurisë objekteve dhe qirave) ne tre vitet e fundit nga data publikimit te njoftimit për kontratë ne vlerës minimumi 30.000 euro kurse dëshmia ka qen një listë e shërbimeve te realizuar ne tre vitet e fundit nga date e publikimit te njoftimit për kontratë duke saktësuar ( shërbime te kryera shumën e kontratës datën dhe pranuesin)

Pika 1 ku shërbimet janë kryer te një AK ne Kosovë ose ne një vend tjetër për dëshmi shërbim (referenca pozitive ose raporti i pranimi te shërbimit ) te lëshuar apo bashkë nënshkruar nga AK i tille (II ku shërbimet janë kryer për një person kompani private për pranim pa kontratë te pranimi ) qe këto dokumente te janë te pranueshme duhet te dëshmohej me transaksion bankar.

Lidhur me këtë pretendim duke u bazuar ne kriterin e FDT qe është kërkuar si e përmenda edhe ma herët shërbime e kryera shumën e kontratës datën dhe pranuesin OE ankues ne dosjen e tij ka bashkëngjijt një listë me titull referencat bashkëngjitura qe cekte emri i bankave dhe institucioneve qe ka kryer shërbime mirëpo nuk cekte shuma data dhe pranuesi.

Po ashtu ka bashkëngjitur edhe një tabelë lidhur me këtë pik ku ne këtë tableta cekte klienti kontakt

adresa edhe kontakt numri pra nuk e përmban shërbimin shumë e kontratës datën dhe pranuesin dhe mendoj se nuk është komfor kërkesës se FDT .

Lidhur me pretendimin e dyte ankimor për vlerësuesin Arkitekt Bujar Prestrshi xhindet ky OE ne listën e stafit te kompanisë – OE ankues CV shpk por ky për këtë person nuk e ka te bashkëngjitur para kontratën.

Lidhur me pretendimin e tret ankimor lidhur me listën ne sqarimin se gjeodeti nuk ka licencë kërkesa e FDT ka qen dëshmi për gjeodetin ka qen CV e gjodetit kopje te nënshkruar nga gjeodeti diploma kopje kontrata valide e punës me punëdhënësi ose para kontrata si dhe letër reference ku dëshmohet përvoja e punës për tre vitet e lëshuar nga punë dhënësi sipas kriterit te FDT ne këtë rast nuk është kërkuar qe gjeodeti te jetë i licencuar.

Lidhur me pretendimin për referencën e Lulzim Krasniqit te lëshuar nga kompania ADVANCIT Business consulting shpk me nr te biznesit 810-847220 kjo kompani është aktive e jo siç pretendon OE ankues me nje kompani me nr biznesi 810-904-640 e cila është pasive nga viti 2019 .

Lidhur me pretendimin ankimor te Hysen Ramabaja dhe Lulzim krasniqi pasi qe kërkesa ka qen qe te bashkëngjitet licenca për këta kontabilist kurse ne dosjen njeri ka certifikatë te anëtarësisë dhe tjetri vërtetim për fitimin thirrjes auditor i certifikuar kam kërkuar qe ta sqaroj AK e unë ne dosje nuk i kom pa.

Lidhur me kontabilistin e certifikuar Burim Selamin OE pretendon se e ka referencën te lëshuar nga Pro ACC grup dhe se pretendon se i njëjti është pronar i kompanisë Bora shpk lidhur me këtë mendoj se KA mund ta sqaroj sipas nenit 72 LPP

Lidhur me pretendimin nr 4 te ofroj minumium 4 punëtor te certifikuar te licencuar te shkalles se par me se paku tre vite provoj pune profesionale pas diplomimit licencimit certifikimet dëshmia për vlerësues është CV kopje e nënshkruar nga vlerësuesi , diploma ose certifikata ose licenca kopje kontrata valide e pune s me punëdhënësin ose para kontratën kopje si dhe letër referencë ku dëshmohet përvoja e punës prej tre viteve e lëshuar nga punëdhënësi lidhur me këtë pretendim OE ankues pretendon se vlerësuesit e paraqitur te OE te rekomanduar Arian Shala , Arben Bajramaj , Behar Junuzu dhe Lorita Sylejmani nuk kan dorëzuar referencë për disa nuk dëshmohet përvoja e punës prej tre viteve e lëshuar nga punëdhënësi i vërtet e qe e vërteton përvojën e punës.

OE ankues pretendon se kontratat për këtë staf janë te kundërligjshme nuk janë ne harmoni me ligjin e punës kjo i bije ne përgjegjësi te kompanisë qe ka nënshkrua kontratat. OE i rekomanduar i ka edhe licencat edhe kontratat e punës.

Te pretendimin nr 5 siç thamë për gjeodetin e sqarova edhe ma herët se kërkesa e AK ka qen minimum një gjeodet te diplomuar minimum niveli bachelor , me se paku tre vite përvoja pune profesionale ( pas diplomimit ) si dëshmi ka qen cv kopje e nënshkruar nga gjeodeti diploma kopje kontrata valide e punës me punëdhënësin ose para kontrata kopje si dhe letër referencë për tre vitet e fundit.

Pra sipas kësaj kërkesës siç pretendon OE ankues se gjeodeti nuk e ka licencën kjo nuk ka qen e kërkuar ne kriteret e FDT qe gjeodeti te bashkëngjitur edhe licencën andaj ky pretendim nuk qëndron.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron;

Lidhur me pretendimin e pare ankimor te OE ankues se AK e ka eliminuar jashtëligjshëm, pasi qe ka dorëzuar listën e kontratave e cila nuk përmbush kërkesat minimale te vlerës se përcaktuar, OE ankuese në ankesë por edhe në seancë ka deklaruar se kërkesën 9.2 e FDT lidhur me dëshmitë për

shërbimet e kryera e ka dëshmuar me kontratat e bashkangjitura dhe me transaksionet bankare. Dhe se lista mbi bazën e të cilës është eliminuar nuk është liste e shërbimeve por liste e referencave. Paneli nuk mbështetet në raportin e ekspertizës sepse pas shqyrtimit të ofertës dhe kërkesave të FDT konstaton se lista në bazë të të cilës AK e ka eliminuar OE ankuese në fakt nuk është liste e shërbimeve dhe kontratave të kryera por një liste e referencave pasi gjendet nën kapitullin referencat tek dëshmitë e ofruara nga OE ankuese. Për më tepër OE ankuese ka bashkangjitur kontratat dhe transaksionet bankare të cilat e mbulojnë shumën e kërkuara dhe e plotësojnë kriterin e FDT. Andaj, AK në bazë të nenit 39.8 të RrUOPP-së ku thuhet se : *Lista e kontratave të realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar dëshmitë (referenca/certifikata e pranimit/kontrata) - Mund të kërkojnë informata sqaruese*, duhet gjatë rivlerësimit të njëjtën ta kërkojë nga OE ankuese. Ky pretendim i OE ankuese është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë të OE ankuese se është eliminuar për shkak se mungon para-kontrata e vlerësuesit Bujar Prestreshit, paneli mbështetet në raportin e ekspertit i cili vlerëson se OE e ka bashkangjitur listën e punëtorëve me 08 punëtorë që i ka të 4 vlerësues të pronave, 3 kontabilist të certifikuar dhe 1 gjeodet dhe se lidhur me vlerësuesin Bujar Prestreshi, nuk qëndron arsyetimi i AK-se, se ky OE është i punësuar në një kompani tjetër, sepse në kriterin e kërkuar nga vet AK, është cekur “*do të angazhohen*”, e nuk ceket që kompania të ketë punëtorët e rregulltë. Andaj për këtë pretendim AK duhet të kërkojë sqarime shtesë lidhur me vlerësuesin Bujar Prestreshi dhe të verifikoj angazhimin e tij në OE ankuese gjatë rivlerësimit, si i tillë ky pretendim i OE ankuese është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e tretë të OE ankuese ndaj OE të rekomanduar se lista e stafit e bashkangjitur nga OE e rekomanduar nuk është origjinale, sepse kriteri i FDT është parapare se duhet të dorëzohen lista e punëtorëve origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik dhe eksperti konstatoi se e njëjta nuk është e bashkangjitur si e tillë nga OE e rekomanduar. Mirëpo, e lista origjinale u prezantua nga AK, pasi që e njëjta ka kërkuar sqarime nga OE e rekomanduar. Andaj paneli konstaton se ky pretendim është i pabazuar.

Po ashtu OE ankuese në pretendimet ankimore ka deklaruar se Hysen Ramabaja dhe Lulzim Krasniqi nuk kanë ofruar licence si kontabilist të certifikuar, paneli pas shqyrtimit të lëndës mbështetet në raportin e ekspertizës se të njëjtit kanë ofruar certifikatë që dëshmon se janë auditor dhe ky titull është një shkallë më lart se kontabilisti. Andaj, pretendimet për Hysem Rambaja dhe Lulzim Krasniqi janë të pabazuara.

Lidhur me pretendimet e OE ankuese se Burim Selmani i OE të rekomanduar është pronar i kompanisë BORA SHPK, paneli mbështet në raportin e ekspertizës me të cilën eksperti konstaton se ligji nuk e ndalon decidivisht se personi mund të ketë punë dytësore, por se a ka punuar apo jo në kompaninë Pro Acc Group, kjo mund të vërtetohet nga AK përmes listës së punëtorëve të kompanisë nga ATK-ja se a ka qene i punësuar i kësaj kompanie nga viti 2018, andaj gjatë rivlerësimit AK duhet të kërkojë sqarime shtesë dhe vërtetojë këtë pretendim.

Lidhur me pretendimin e katërt për Arian Shala dhe Arben Bajramaj se të dy punojnë edhe në kompani tjera, paneli duke u mbështetur në raportin e ekspertizës dhe shqyrtimit të dosjes se lëndës konstaton se të dy punëtorët e kanë të deklaruar se janë të angazhuar në Pro ACC Group me orar të shkurtuar, andaj AK gjatë rivlerësimit duhet ta vlerësojë se a është i mjaftueshëm ky angazhim për realizim e njoftimit për kontratë.

Lidhur me pretendimin e OE ankuese se Lorida Sylejmani nuk i tri vite përvojë pune, në bazë të raportit të ekspertizës konstatohet se e njëjta cila është vlerësuese e pronave dhe se referencën e ka

te lëshuar nga vet OE i rekomanduar Pro Acc Group, e njëjta ne dosje ka te bashkangjitur Licencën për Vlerësues te Pronave te Paluajtshme me nr. te licencës 281 nga data 13.09.2021 deri 12.09.2022 Pra, ne dosjen e saj gjinden tri (3) licenca: a) 17.11.2017 — 17.11.2019; b) 07.11.2019 — 07.11.2021 dhe c) 13.09.2021 — 12.09.2022. Lorida Sylejmani sipas linkut qe keni bashkangjitur te vitit 2021 e vërtete qe licencën e ka pasur pasive, por ne listën e vitit 2022 e cila gjendet ne web faqen e Këshillit Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve <https://mf.rks-gov.net/pace.aspx?id=1,183> dëshmohet se Lorida Sylejmani ka licencë valide prej dates 13.09.2021 deri 12.09.2022. Andaj paneli konstaton se ky pretendim nuk është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e peste ankimorë se gjeodeti i OE te rekomanduar nuk e plotëson kriterin sepse nuk ka licence valide, duke u bazuar ne ekspertizën e ekspertit si dhe kërkesës ne FDT ku ceket: “Min një (1) Gjeodet të diplomuar min niveli Bachelor, më së paku 3 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit)”, OE e rekomanduar ka prezantuar kontratës e punës, referencat dhe diplomën e fakultetit (bachelor i Gjeodezise) me te cilat e dëshmon se ka plotësuar kërkesën sipas FDT. Andaj ky pretendim është i pabazuar.


Vendimi lidhur me kthimin e tarifës u dha ne kuptim te nenit 31 paragrafi 6 i Rregullores se punës se OSHP-se.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryetare e Panelit Shqyrtues

  
znj.Nita Bejta

#### Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK– Ndermarja Publike
- 1x1 OE ankuese “CV SHPK”
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.